

**UDHËZIM**  
**Nr. 4, datë 10.2.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE TË VLEFSHMËRISË SË CERTIFIKATËS SË SIGURISË PËR MJETET LUNDRUESE TURISTIKE DHE TË ARGËTIMIT DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR NJOHJEN E SHOQËRIVE TË HUAJA KLASIFIKUESE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 4, pikat 4 dhe 6, të ligjit nr. 127/2020, “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit”,

UDHËZOJ:

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i afateve të vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë për mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit, si dhe përcaktimi i kriterëve standardeve që duhet të plotësohen nga shoqëritë e huaja klasifikuese me qëllim njohjen e tyre nga shoqëria klasifikuese e njohur nga Administrata Detare Shqiptare.

Neni 2  
**Fusha e zbatimit**

1. Ky udhëzim zbatohet për të gjitha mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit, të klasifikuara si të tilla nga shoqëria klasifikuese, me kapacitet deri në 12 pasagjerë, pa përfshirë ekuipazhin e mjetit lundrues, me motor me fuqi mbi 30 kw ose 40.8 kf dhe tonazh nën 500 gt, që mbajnë flamurin shqiptar ose përdorin hapësirën detare shqiptare dhe ujërat e brendshme tokësore.

2. Ky udhëzim nuk zbatohet për mjetet lundruese në përdorim të Forcave të Armatosura, Kapitenerive të Porteve, Policisë Kufitare, Doganës dhe organeve të tjera shtetërore të parashikuara me ligj.

Neni 3  
**Përkufizime**

**1. “Administrata Detare”** – është tërësia e strukturave të angazhuara në fushën e detarisë, sipas ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë.

**2. “Drejtoria e Përgjithshme Detare”** – është autoriteti përgjegjës për funksionimin e administratës detare, për politikën e zhvillimit të transportit detar dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit për fushën e detarisë, në varësi të ministrit përgjegjës për transportin detar .

**3. “Shoqëri klasifikuese shqiptare”** – shoqëria klasifikuese Shqiptare e krijuar sipas dispozitave të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë dhe që njihet nga Administrata Detare Shqiptare.

4. **“Certifikatë sigurie apo të klasit”** – është dokumenti i lëshuar nga shoqëria klasifikuese, e krijuar sipas dispozitave të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

5. **“Shoqëri klasifikuese e huaj”** – shoqëri klasifikuese e njohur nga administrata detare e vendit të origjinës.

6. **“Mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtim”** – janë mjetet sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me tonazh nën 500 gt, që kanë një fuqi të përgjithshme të motorit ose të motorëve të marrë së bashku më të lartë se 30 kw ose 40.8 kf, të klasifikuara si të tilla nga Regjistri Detar Shqiptar ose nga institucionet korresponduese të shteteve të tjera, që përdoren për qëllime turistike dhe argëtimi.

## KREU II SHOQËRITË KLASIFIKUESE DHE CERTIFIKATA E SIGURISË

### Neni 4 **Shoqëritë klasifikuese të huaja**

1. Shoqëria klasifikuese shqiptare e njohur nga administrata detare lëshon certifikatat respektive për mjetet turistike dhe të argëtimit të certifikuara nga një shoqëri klasifikuese e huaj e njohur prej saj.

2. Një shoqëri klasifikuese e huaj për t'u njohur nga shoqëria klasifikuese shqiptare duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në aneksin I, të këtij udhëzimi si dhe duhet të ketë marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë klasifikuese shqiptare.

3. Shoqëria klasifikuese shqiptare vë në dijeni Administratën Detare Shqiptare për marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura me shoqëritë klasifikuese të huaja brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së marrëveshjes.

### Neni 5 **Certifikata e Sigurisë**

1. Të gjitha mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit duhet të jenë të pajisura me certifikatë sigurie.

2. Pas kryerjes së kontrollit teknik lëshohet certifikata e sigurisë për mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit me afat 1-vjeçar.

3. Për mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit, certifikata e sigurisë do të lëshohet nga shoqëria klasifikuese e njohur nga administrata detare shqiptare ose do të konvertohet ajo e lëshuar nga shoqëritë e huaja të njohura prej saj, mbas kryerjes së kontrollit teknik të mjetit sipas pikës 2 të këtij neni.

### Neni 6 **Dispozita e fundit**

Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Administrata Detare Shqiptare, shoqëria klasifikuese shqiptare dhe shoqëritë klasifikuese të huaja.

### Neni 7 **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
**Belinda Balluku**

ANEKS I  
KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË NJË SHOQËRI KLASIFIKUESE E HUAJ PËR  
TËU NJOHUR NGA SHOQËRIA KLASIFIKUESE E NJOHUR NGA ADMINISTRATA  
DETARE SHQIPTARE

1. Shoqëria e huaj duhet të jetë e njohur nga një administratë detare e vendit të origjinës;
2. Shoqëria e huaj klasifikuese duhet të ketë seli pranë zyrës ku ndodhet regjistri i mjeteve lundruese shqiptare sipas dispozitave të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë;
3. Të vërtetojë se ka funksionuar si një shoqëri klasifikuese për certifikimin e mjeteve lundruese për lundrime ndërkombëtare për të paktën 10 vjet sipas rregulla të veta klasore;
4. Të ketë një tonazh total të klasifikuar prej të paktën 20 mijë tonë bruto;
5. Të ketë burime njerëzore të mjaftueshme për funksionim e saj;
6. Të disponojë ambiente zyrash të mjaftueshme me qëllim garantimin e ruajtjes së vazhdueshmërisë së procedurave menaxheriale dhe administrative;
7. Të jetë e certifikuar me një sistem të brendshëm cilësie ISO 9001 ose një standard cilësie ekuivalente;
8. Të mos ketë konflikt interesi me pronarët e mjeteve lundruese, ndërtuesve të mjeteve lundruese ose të tjerëve të angazhuar komercialisht në prodhimin, pajisjen, riparimin ose funksionimin e mjeteve lundruese;
9. Të mos përfshihen në asnjë aktivitet që mund të rezultojë në konflikt interesi.